

# Anketa e Arsimimit të të Rriturve

Metadate Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports  
Structure (ESQRS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Paraqitja statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor .....	4
4. Manaxhimi i cilësisë .....	4
5. Rëndësia.....	5
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	5
7. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	7
8. Koherenca dhe krahasueshmëria.....	8
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	8
10. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
11. Konfidencialiteti .....	9
12. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Popullsisë, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Olta Caca
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave të Popullsisë
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ocaca@instat.gov.al">ocaca@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Paraqitja statistikore</b>	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa e Arsimit të të Rriturve (Adult Education Survey, AES) mat përfshirjen e të rriturve në arsim dhe trajnim sipas tipeve të të mësuarit (zyrtar – Formal Education (FED), jo-zyrtar – Non Formal Education (NFE) dhe të mësuarit informal – Informal Education (INF)). AES 2016 fokusohet në popullsinë e grupmoshës 25-64 vjeç. Periudha referencë për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim është dymbëdhjetë muaj para intervistës. Informacioni i disponueshëm nga AES grupohet sipas temave të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja në arsimin zyrtar, arsimin jo-zyrtar dhe trajnimin dhe të mësuarit informal</li> <li>• Numri i orëve të mësimit</li> <li>• Karakteristikat e aktiviteteve të të mësuarit</li> <li>• Arsytet për pjesëmarrje</li> <li>• Pengesat dhe vështirësitë për pjesëmarrje</li> <li>• Qasja në informacion mbi mundësitë e të mësuarit</li> <li>• Financimi nga punëdhënësi dhe kostot e të mësuarit</li> <li>• Vetë-përceptimi i aftësive gjuhësore</li> </ul>
2.2. Sistemi i klasifikimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikimi i Aktiviteteve të të Mësuarit (CLA, edicioni 2016)</li> <li>• Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit 2011 (ISCED 2011)</li> <li>• Fushat e Arsimit dhe Trajnimit (ISCED-F 2013)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikimi i Profesioneve 2008 (ISCO 08)</li> <li>• Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike Rev. 2 (NACE Rev.2)</li> <li>• Kodet e qarkut (NUTS 2)</li> <li>• Kodet e gjuhëve (ISO-639)</li> </ul>
2.3. Mbulimi i sektorit	Kampioni i anketës përfshin individë të grupmohave 25-64 vjeç, banorë të zakonshëm që jetojnë në Njësi Ekonomike Familjare. AES përfshin të gjithë sektorët ekonomikë.
2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><i>Një njësi ekonomike familjare (NjEF)</i> i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.</p> <p><i>Të mësuarit gjatë gjithë jetës:</i> Të gjitha aktivitetet mësimore të ndërmarra gjatë gjithë jetës, me qëllim të përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave, brenda perspektivave personale, qytetare, sociale dhe të lidhura me punësimin.</p> <p><i>Arsimi zyrtar</i> përcaktohet si arsim i siguar nëpërmjet sistemit të shkollave, kolegjeve, universiteteve dhe institucioneve të tjera arsimore zyrtare që normalisht përbën një "shkallë" të vazhdueshme të edukimit me kohë të plotë për fëmijët dhe të rinjtë, në përgjithësi duke filluar nga mosha pesë deri në shtatë vjeç dhe duke vazhduar deri në 20 ose 25 vjeç.</p> <p><i>Arsimi jo-zyrtar</i> përcaktohet si çdo aktivitet i organizuar dhe i qëndrueshëm arsimor që nuk korrespondon me përkufizimin e mësipërm të arsimit zyrtar. Arsimi jo-zyrtar mund të zhvillohet si brenda dhe jashtë institucioneve arsimore dhe përfshin të gjithë personat pa kufizim moshe.</p> <p>Përkufizimet si dhe lista e variablave të përfshirë në këtë anketë janë të disponueshme në manualin e AES 2016 në linkun më poshtë: <a href="http://ec.europa.eu/eurostat/web/education-and-training/methodology">http://ec.europa.eu/eurostat/web/education-and-training/methodology</a>.</p>
2.5. Njësia statistikore	Individët që jetojnë në Njësinë Ekonomike Familjare dhe aktivitetet mësimore.
2.6. Popullata statistikore	<p>Popullsia e synuar për AES ishin të gjithë individët e moshës 25-64 vjeç, të cilët ishin vendbanues të zakonshëm dhe jetonin në NJEF.</p> <p>Popullsia e grupmohës 25-64 vjeç: 1.501.421 individë.</p> <p>Kampioni nga Census 2011: 5.264 NJEF</p> <p>Individët e përgjigjur në databazën e transmetuar në Eurostat: 3.796 individë</p>
2.7. Zona e referencës	Territori i Shqipërisë (AL1).
2.8. Mbulimi në kohë	AES u zhvillua për herë të parë në Shqipëri për vitin referencë 2016.
2.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.

### 3. Përpunimi statistikor

3.1. Burimi i të dhënave	<p>Burimi i të dhënave të AES është vrojtimi i realizuar gjatë periudhës 02/05/2017 deri në 30/06/2017.</p> <p>Baza e zgjedhjes së AES ishte Censusi i popullsisë 2011. Dizenjimi i kampionit të AES bazohet në metodën e stratifikimit me 2 hapshe.</p> <p>Në hapin e parë, u përzgjedhën 440 ZC (Zona Censusi) si njësi primare kampionimi (Primary Sampling Unit, PSU) me metodën PPS-sys(Probability Proportion to Size - Systematic). Në fazën e dytë u përzgjedhën 5.264 familje. Shpërndarja e kampionit ishte proporcionale në të gjithë popullsinë.</p> <p>Stratifikimi u realizuar në 24 strata pra në 12 Qarqe dhe 2 zona urbane/rurale (12 qarqe x 2 zona = 24 strata).</p>
3.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Kjo ishte hera e parë që Shqipëria zhvilloi AES. Në vazhdimësi kjo anketë do të zhvillohet çdo pesë vite.</p>
3.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Mbledhja e të dhënave u krye nëpërmjet intervistave ballë për ballë. Para fillimit të mbledhjes së të dhënave në terren, pyetëtori u testua me një kampion të thjeshtë dhe intervistuesit u trajnuan për mënyrën e anketimit dhe metodologjinë që duhej ndjekur.</p>
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Vlerësimi i të dhënave kryhet nga INSTAT dhe testet e cilësisë kryhen nga Eurostat.</p>
3.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Jo e aplikueshme</p>
3.6. Rregullimi	<p>Jo e aplikueshme.</p>
<b>4. Manaxhimi i cilësisë</b>	
4.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
4.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Për kriteret e cilësisë, i referohet manualit të AES të ofruar nga Komisioni Evropian, përveç kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e</p>

	Komisionit (BE) Nr. 1175/2014. Të gjitha procedurat statistikore të kryera për këtë studim janë në përputhje të plotë me kërkesat e rregullores dhe rekomandimet e Eurostat, me qëllim që të sigurohet prodhimi i cilësisë së lartë dhe rezultateve të harmonizuara.
<b>5. Rëndësia</b>	
5.1. Nevojat e përdoruesit	Lista e përdoruesve kombëtarë përfshin: institucionet, ministritë, departamentet qeveritare, mediat, ndërmarrjet, studiuesit dhe studentët. Në nivel kombëtar, të dhënat e AES-së do të publikohen në një njoftim për shtyp. Përdoruesit gjithashtu kanë mundësinë të kërkojnë të dhëna të mëtejshme nëpërmjet një kërkesë të veçantë nëpërmjet faqes së internetit të INSTAT-it.
5.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT për të dhënat e AES nuk kryen ndonjë studim të përkushtuar të kënaqshmërisë së përdoruesve.
5.3. Plotshmëria	Kjo përlllogaritje ka marrë parasysh treguesit e prodhuar nga EUROSTAT në lidhje me treguesit e prodhuar nga Njësia e Popullsisë për këtë studim.
5.3.1. Plotshmëria e të dhënave - shkalla e plotshmërisë së të dhënave	Plotësia e të dhënave për Anketën e Arsimit të Rriturve (AES) 2016 është rreth 100%.
<b>6. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
6.1. Saktësia e përgjithshme	Kampioni i përdorur për AES 2016 është databaza e Censusit 2011. Madhësia e kampionit ishte 5.264 NJEF dhe të përgjigjurit ishin 3,796 individë.
6.2. Gabim i kampionimit	Anketa bazohet në një kampion probabilitar prej rreth 5.264 NJEF. Përzgjedhja e njësive ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë sa më shumë saktësinë e vlerësimeve për treguesit kryesorë të AES.
6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët	Aneksi 1 përmban informacion për: Koeficientin e Variacionit, Gabimin Standard dhe Intervalin e Besimit.
6.3. Gabim jo i kampionimit	Në një vrojtim me zgjedhje mund të shfaqen dy lloj gabimesh (devijimesh statistikore). Një nga këto lloje është gabimi i zgjedhjes, i cili përcaktohet si 9 diferencë midis treguesit të zgjedhjes dhe treguesit përkatës të popullimit. Gabimi i zgjedhjes ndodh për shkak të moszgjedhjes të të gjithë njësive nga popullimi që studiohet. Lloji i dytë i gabimeve përfshin të gjitha gabimet që nuk lidhen me zgjedhjen, siç janë gabimet e matjes, të pyetjes e të përgjigjeve, gabimet e përpunimit, etj. Intervistuesit janë udhëzuar që të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përzgjedhur individin e përshtatshëm për të kryer intervistat për AES.

6.3.1. Gabimi në mbulim	Gabimi i mbulimit përfshin si mbi-mbulim dhe nën-mbulimin. Nënmbulimi ndodh kur baza e zgjedhjes që përdoret mbulon vetëm familjet private dhe jo personat që jetojnë në familje institucionale. Meqenëse Censusi i vitit 2011 përdoret si bazë zgjedhjeje, familjet e krijuara pas vitit 2011 nuk janë të përfaqësuara mirë. Mbi-mbulimi ndodh kur ka mbipërfaqësim për familjet e krijuara para vitit 2011 dhe për familjet të cilat ishin prezent në 2011 dhe nuk janë pas 2011. Baza e zgjedhjes në AES është Censusi i popullsisë i vitit 2011 i cili nuk është azhurnuar. Mund të ketë nën-mbulim të familjeve të krijuara rishtazi. Nuk mund të matet nën-mbulimi sepse nuk është bërë një azhurnim i bazës së zgjedhjes. Mbi-mbulimi lidhet me banesat në të cilat banorët nuk janë të pranishëm për një kohë të gjatë, nuk janë të banuara ose banohen sezonalisht, bëhen të pabanueshme (për shembull dyqan), janë në likuidim, nuk gjenden (adresa e pasaktë).
6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit	Shkalla e mbi-mbulimit për AES 2016 është 9,1 %.
6.3.1.2. Pjesa e njësisve që mbulohet edhe nga anketa edhe nga burimi administrativ	Nuk aplikohet pasi nuk përdoren të dhëna administrativ.
6.3.2. Gabimi në matje	Pyetëtori ishte në format PAPI, kështu që informacioni u mblodh nga intervistuesi ballë për ballë me letër. Pas mbledhjes së të dhënave në letër, programi i hedhjes së të dhënave është përgatitur me CSPro 6.0 dhe kontrole logjike janë vënë në mënyrë që të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur ndonjë gabim. Kodet unike të NJEF-ve, zonës së censusit, rajonit, prefekturës etj. ishin para-mbushur dhe nëse kombinimi ishte i gabuar sistemi të paraqiste një kuti me tekst, e cila të sygjente të korrigjonte të dhënat. Për disa variabla të vështira të tilla si ISCO, NACE, kodin e gjuhëve, etj është mbledhur informacioni me tekst të lirë dhe më pas është koduar.
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Mos-përgjigjia merr parasysh familjet që nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshme të përgjigjen, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje të gjejnë familje ose kur ka pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.
6.3.3.1. Shkalla e mos-përgjigjes së njësisve	Shkalla e mos-përgjigjes në anketë është 21,3 %.
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	Për variablin HHINCOME mos-përgjigjia ishte 13,0 %.
6.3.4. Gabimi në procesim	Pyetëtori ishte në format PAPI, kështu që informacioni u mblodh nga intervistuesi ballë për ballë në letër. Pas grumbullimit të të dhënave në letër, programi i futjes së të dhënave u përgatit me CSPro 6.0 dhe u

	<p>vendosën kontrolle logjike për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur ndonjë gabim. Për disa variabla të vështira të tilla si ISCO, NACE, kodin e gjuhëve etj., informacioni u mbledh si tekst i lirë dhe më pas u kodua. Në përgjithësi nuk ka pasur imputim të vlerave të zhdukura, përveç variantit HHINCOME. Për këtë variabël janë llogaritur të ardhurat mesatare të NJEF sipas qarqeve dhe rastet e mospërgjigjes ishin rreth 13,0 % dhe editimi i të dhënave ishte rreth 2,0 %.</p>
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	<p>Në përgjithësi nuk është bërë imputim i vlerave që mungojnë, përveç variablit HHINCOME. Për këtë variabël, u llogarit e ardhura mesatare e familjeve sipas qarqeve dhe rastet e mos përgjigjes ishin rreth 13,0% dhe editimi ishte rreth 2,0%</p>
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar për vlerësim	<p>Jo e aplikueshme.</p>
6.4. Rregullimi stinor	<p>Nuk ka rregullim për të dhënat</p>
6.5. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të AES bëhen në përputhje me politikën e revizionimit statistikor dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë informacion referojuni:  <a href="http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf">http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf</a>  <a href="http://instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf">http://instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf</a></p>
6.6. Praktika e rishikimit	<p>Jo e aplikueshme.</p>
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	
<p><b>7. Afatet kohore dhe përpikmëria</b></p>	
7.1. Afatet kohore	<p>Afati kohor mes datës së publikimit të të dhënave dhe përfundimit të periudhës referuese është rreth 495 ditë (T + 495).</p>
7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare	<p>Nuk ka publikim të rezultateve paraprake.</p>
7.1.2. Publikimi i rezultateve finale	<p>T+495 ditë.</p>
7.2. Përpikmëria	<p>Në fund të çdo viti, INSTAT publikon një Kalendar të publikimit për vitin e ardhshëm: <a href="http://instat.gov.al/al/publikime/kalendari/">http://instat.gov.al/al/publikime/kalendari/</a></p>

7.2.1. Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi	INSTAT ishte i përpiktë në kohë me të dhënat e AES 100 %.
<b>8. Koherenca dhe krahasueshmëria</b>	
8.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat janë plotësisht të krahasueshme. Përveç kësaj, nuk ka dallime të koncepteve kombëtare nga konceptet evropiane në lidhje me përcaktimin e popullsisë rezidente, të mësuarit gjatë gjithë jetës etj.
8.1.1. Asymmetry for mirror floë statistics - coefficient	Jo e aplikueshme
8.2. Krahasueshmëria kohore	AES 2016 ishte hera e parë në të cilën mori pjesë Shqipëria.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	Jo e aplikueshme
8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Për një krahasim të përgjithshëm të strukturës së popullsisë së AES 2016 është marrë në konsideratë popullsia e EU-LFS sipas moshës, gjinisë dhe nivelit arsimor.
8.4. Koherenca e të dhënave me frekuenca të ndryshme mbledhjeje	Jo e aplikueshme
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Jo e aplikueshme
8.6. Koherenca e brendshme	Jo e aplikueshme
<b>9. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
9.1. Njoftim për media	Të dhënat janë të publikuara në faqen e webit të INSTAT. <a href="http://www.instat.gov.al">http://www.instat.gov.al</a>
9.2. Publikime	Formati i publikimit është një seksion i dedikuar në faqen e internetit të INSTAT-it.
9.3. Baza e të dhënave on-line	Bazën e të dhënave mbi Anketën e Arsimimit të të Rriturve mund të aksesohet në linkun më poshtë: <a href="http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/">http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/</a>
9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	Jo e aplikueshme



9.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Bazat e të dhënave në nivel mikro nuk publikohen për arsye të konfidencialitetit.
9.5. Të tjera	Micro-data i janë dërguar Eurostat-it.
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet e koncepteve kryesore dhe shpjegimet metodologjike u ofrohet përdoruesve në fund të njoftimeve për shtyp dhe publikimeve. Informacion shtesë mbështetës u jepet përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme ose kërkohet.
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Popullsisë dokumentin gjithë procesin e punës për AES për përdorim të brendshëm.
9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadata-ve	Nuk plotësohet nga Instat, llogaritjet nga Eurostat pasi metadata publikohet.
9.7.2. Metadata - Konsultimet	
<b>10. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Koha mesatare e përgjigjes në pyetësor (në minuta): rreth 30 minuta - për pyetësorin e familjes dhe për pyetësorin individual.
<b>11. Konfidencialiteti</b>	
11.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 15 i ligjit për statistikave zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka marrë ose ka qasje, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore që i kanë dhënë ato me zbulimin e informacionit individual të marrë drejtpërsëdrejti për qëllime statistikore ose furnizim indirekt nga burime administrative ose burime të tjera . Instituti i Statistikave të Shqipërisë merr të gjitha masat e duhura parandaluese për të bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore individuale me mjete teknike ose të tjera që mund të përdoren në mënyrë të arsyeshme nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që potencialisht mundësojnë identifikimin e njësisë statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave

të Shqipërisë nëse dhe vetëm nëse:

- Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, në mënyrë të tillë që shpërndarja e tyre nuk paragjykon konfidencialitetin ose
- Njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa ndonjë rezervë, për zbulimin e të dhënave.

Të dhënat konfidenciale që transmetohen në Institutin e Statistikave të Shqipërisë përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe personat e vetëm që kanë të drejtë të kenë qasje në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që kanë të bëjnë me respektimin e konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga personeli që punon në Institutin Shqiptar të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi duhet të rekomandojnë: nivelin e detajeve në të cilat mund të shpërndahen të dhënat statistikore, ashtu që identifikimi, në mënyrë direkte ose indirekte, i njësisë statistikore të anketuar nuk është e mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u ofrohen përdoruesve; qasja e kërkuesve në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

## 12. Komente

Nuk ka komente.

## Aneks

Tabela 1: Gabimet e kampionimit për AES 2016

Indikatori	Vlera e estimuar e indikatorit (peshuar)	Koeficienti i variacionit	Devijimi standard	Intervali I besimit 95%	Numri I të përgjigjurve (net sample)
Shkalla e pjesmarrjes në arsimin zyrtar, moshë 25-64 vjeç, gjithsej - %	1.7	16.6	0.3	[1.2;2.3]	43
Shkalla e pjesmarrjes në arsimin jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, gjithsej - %	8.2	6.0	0.5	[7.3;9.2]	284
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, femra - %	8.6	8.6	0.7	[7.3;10.2]	150
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, meshkuj - %	7.8	9.0	0.7	[6.5;9.3]	134
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-34 vjeç, gjithsej - %	14.6	9.6	1.4	[12.1;17.6]	103
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 35-54 vjeç, gjithsej - %	6.8	8.5	0.6	[5.8;8.1]	141
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 55-64 vjeç, gjithsej - %	3.5	16.3	0.6	[2.5;4.8]	40
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, me arsim të ulët (ISCED 0-2) - %	1.6	18.8	0.3	[1.1;2.2]	31
Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, me arsim të mesëm (ISCED 3-4) - %	6.4	11.4	0.7	[5.1;7.9]	83

Shkalla e pjesmarrjes në arsim jo-zyrtar, moshë 25-64 vjeç, me arsim të lartë (ISCED 5-8) - %	29.2	7.3	2.1	[25.2;33.6]	170
Shkalla e pjesmarrjes në të mësuarit informal, moshë 25-64, gjithsej - %	67.8	1.0	0.7	[66.5;69.0]	2531